

PLANI EKONOMIK LOKAL PËR  
KATEGORITË E CENUESHME TË  
QYTETARËVE, TË  
RIATDHETSUARVE DHE  
ANËTARËVE TË FAMILJEVE TË  
TYRE PËR KOMUNËN E  
HARAÇINËS

Ky publikim është përgatitur si pjesë e projektit “Rruga drejt rezistencës dhe riintegritit të familjeve të cenueshme në komunitet”, i cili zbatohet nga një konsorcium i organizatave: Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar - MCMS, Nexus - Koncepti qytetar, Iniciativa për Perspektivë Evropiane - IEP , Horizon Civitas dhe Pleiades. Projekti mbështetet nga Fondi global i angazhimit dhe rezistencës së Komunitetit-GCERF.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi vetëm e autorit dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se i pasqyron pikëpamjet e GCERF ose organizatave të tjera që e zbatojnë programin.

Autor: Goran Veleski

shkurt - prill 2022

## Përmbajtja

Rezyme.....	3
Metodologjia për përpilimin e planit ekonomik lokal për kategoritë e cenueshme të qytetarëve dhe riintegrimi i të riatdhesuarve dhe anëtarëve të familjeve të tyre në Komunën e Haraçinës .....	6
Të dhëna themelore për Komunën e Haraçinës .....	7
Risocializimi, rehabilitimi dhe riintegrimi i të riatdhesuarve dhe anëtarëve të familjeve të tyre .....	8
Riintegrimi ekonomik – Qëllimi strategjik dhe masat.....	10
Identifikimi i barrierave me të cilat përballen të riatdhesuarit dhe anëtarët e familjeve të tyre në tregun e punës .....	11
Orientimi në karrierë .....	11
Forcimi i kualifikimeve dhe shkathtësive lidhur me punësimin.....	12
Punësimi i subvencionuar në organizatat qytetare me mision social (ndërmarrje sociale) ose ndërmarrje me përgjegjësi shoqërore .....	13
Vetëpunësimi .....	14
Rekomandime .....	15

# Plani ekonomik lokal për kategoritë e cënueshme të qytetarëve duke përfshirë të riatdhesuarit dhe anëtarët e familjeve të tyre për Komunën e Haraçinës

---

## Rezyme

Plani për riintegrimin e të riatdhesuarve dhe anëtarëve të familjeve të tyre paraqet një dokument zhvillimi i përpiluar mbi bazën e të dhënave aktuale dhe prioriteteve të përcaktuara në momentin e miratimit të tij. Plani është fleksibël, vazhdimisht i përditësuar dhe i përshtatur ndaj nevojave të shfrytëzuesve dhe tendencave aktuale të mbrojtjes sociale në shoqëri.

Sfidat me të cilat përballen të riatdhesuarit pas kthimit në Republikën e Maqedonisë së Veriut janë përjashtimi social, marginalizimi dhe varfëria. Aksesit në shërbimet sociale, punësimi, arsimit dhe strehimi janë pika kyçe mbi të cilat duhet të punohet në mënyrë që të riintegrohen në mënyrë efektive këto grupe të synuara.

Të gjitha masat dhe aktivitetet e ndërmarra nga institucionet bazohen në obligimet e Planit kombëtar dhe procedurave për risocializim, rehabilitim dhe riintegrim të riatdhesuarve nga ushtritë e huaja dhe anëtarëve të familjeve të tyre, të miratuara nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe për koordinimin dhe zbatimin e të cilit është përgjegjës Komiteti kombëtar për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe luftën kundër terrorizmit.

Riintegrimi nënkupton një proces të risocializimit të viktimës me qëllim të ripërfshirjes në familje ose komunitet. Në fakt, është një proces afatgjatë dhe i shumanshëm, përmes të cilit të riatdhesuarit do të kenë mundësinë të riintegrohen në shoqëri, të ndjehen si pjesë e shoqërisë, në mënyrë që të bëhen anëtarë aktivë të jetës ekonomike, kulturore, civile dhe politike në vend. Gjatë vetë riintegrimit ka shumë mundësi që të shfaqen një sërë problemesh, por veprimi sistematik dhe vullneti për bashkëpunim i të gjitha subjekteve shoqërore të referuara mund t'i japë rezultatet e dëshiruara.

Në komunën e Haraçinës një pjesë e ekonomisë është joformale. Disa nga këta individë nuk aktivizohen në tregun e punës dhe janë të dekurajuar nga kërkimi i punësimit formal. Me punësimin formal, njerëzit do të humbasin përfitimet sociale të papunësisë dhe do të përballen me rrezikun e përmbarrimit të të ardhurave të tyre për shkak të detyrimeve të prapambetura. Për disa kategori të cënueshme të qytetarëve, kostoja oportune për të shkuar në punë është shumë

e lartë, sepse veprimet e tyre udhëhiqen nga mundësia që ata thjesht të mund të gëzojnë përfitimet, duke mos bërë asgjë<sup>1</sup>.

Komuna e Haraçinës ka një buxhet të vogël prej rreth 300.000 euro, të cilat i mbledh nga TVSH-ja dhe përpiqet t'i përmirësojë kushtet e jetesës së qytetarëve. Pozita rurale e komunës ofron një potencial të mirë për rritjen e zhvillimit të bujqësisë dhe blegtorisë tashmë ekzistuese duke investuar në qendra blerëse dhe magazina, si dhe një avantazh solid për investime në objektet përpunuese. Ekzistenca e rrjetit të gazsjellësit në komunë i jep përfitime energjetike investimeve të reja. Infrastruktura e mirë rrugore dhe afërsia e aeroportit të Shkupit mundësojnë zhvillimin e industrisë së lehtë tashmë ekzistuese si dhe promovimin e aktiviteteve komerciale.

Në komunë, punëdhënësit vendas kanë kërkesë për fuqi pune për punëtorët të ndërtimit, zejtarët (p.sh. drugdhendja), mjeshtër për përpunimin e mobileve, si dhe një nevojë për punëtorë për të punuar në fermë dhe ambalazhimin e produkteve. Kategoritë e cenueshme të qytetarëve, duke përfshirë të riatdhesuarit dhe anëtarët e familjeve të tyre, mund të ofrojnë kushte më të mira jetese dhe integrim ekonomik përmes trajnimeve për punë dhe subvencionimit të pagave në ndërmarrjet lokale. Personat që kanë njohuri dhe aftësi (p.sh. zejtarët) mund të vetëpunësohen, për të cilin do të marrin grant nga Agjencia e punësimit.

Në komunën e Haraçinës, subjektet e intervistuar deklaruan se nuk kanë bashkëpunim apo përkrahje nga ndonjë institucion tjetër vendor apo i huaj në procesin e punësimit apo ngritjes së kapaciteteve të stafit ekzistues, edhe pse në masë të madhe thuhet se kjo është më se e nevojshme.

Në vitin 2022, në Haraçinë u hap një zyrë e disperzuar e Qendrës për punësim - Shkup, me qëllim të afrimit të shërbimeve të cilat i ofron Agjencia e punësimit për të papunët dhe ndërgjegjësimin e tyre për aktivitetet që i realizon institucioni. Në zyrën e disperzuar, personat e papunë do të mund të regjistrohen për herë të parë dhe të regjistrohen rregullisht si persona të papunë, si dhe të marrin informacion për të gjitha shërbimet e ofruara. Me këtë do të reduktohen kostot e transportit dhe do të mundësojë ndërgjegjësim më të madh, me qëllim përfshirjen e tyre në tregun e punës. Në zyrën e disperzuar, personat e papunë do të mund të pajisen me vërtetim se janë të papunë, si dhe të marrin informacion të saktë dhe në kohë për masat dhe programet aktive që janë pjesë e Planit operativ vjetor për punësimi të zbatuar nga Agjencia e punësimit.

Aktorët kryesorë në riintegrimin ekonomik të riatdhesuarve dhe familjeve të tyre në nivel lokal janë Komuna e Haraçinës, Qendra për punësim - Shkup, ndërmarrjet lokale me përgjegjësi shoqërore, organizatat lokale qytetare me mision social (ndërmarrjet sociale), ofruesit lokal të trajnimeve të certifikuar për të rriturit, Qendra për punë sociale - Shkup dhe shkollat e mesme profesionale në nivel lokal dhe në nivel të Qytetit të Shkupit.

---

<sup>1</sup> Kurth për papunësinë.

*“Ish-luftëtarët, veçanërisht nëse janë ende të rinj, mund të bëhen të ashtuquajturit “brezi i humbur, një kategori njerëzish që gjatë konfliktit janë të privuar nga shkollimi dhe punësimi, duke vuajtur nga traumat e luftës dhe duke transformuar gjithçka në njerëz të varur nga droga dhe alkooli, armët dhe dhuna, duke trajtuar gjithçka sikur është e vetmja mënyrë e jetës. Kur këta persona mbeten jashtë mjedisit militarist, përballen me vështirësi serioze për t'u përshtatur me jetën normale civile.” - The United Nations (UN), Integrated disarmament, demobilization and reintegration standards (IDDRS) -IRDRS 2006*

## Metodologjia për përpilimin e planit ekonomik lokal për kategoritë e cenueshme të qytetarëve dhe riintegrimi i të riatdhesuarve dhe anëtarëve të familjeve të tyre në Komunën e Haraçinës

Plani ekonomik për kategoritë e cenueshme të qytetarëve dhe riintegrimi i të riatdhesuarve dhe anëtarëve të familjeve të tyre në shoqëri në Komunën e Haraçinës është përgatitur duke mbledhur, organizuar dhe sintetizuar në mënyrë sistematike informacionet në dispozicion.

Hulumtimi kishte për qëllim kuptimin e kontekstit në vend në nivel kombëtar dhe lokal, si dhe prioritetet dhe tendencat e riintegritit ekonomik të riatdhesuarve dhe anëtarëve të familjeve të tyre. Po aq e rëndësishme, u identifikuan gjithashtu boshllëqet me të cilat përballen të riatdhesuarit dhe anëtarët e familjeve të tyre që duhet të adresohen gjatë riintegritit të mëtejshëm ekonomik.

Aktivitetet përfshijnë analizën e literaturës ekzistuese, analizë e të dhënave dytësore dhe krijimin e një liste referimi në mënyrë që të gjitha dokumentet të jenë të organizuara dhe lehtësisht të aksesueshme.

Analiza e literaturës ekzistuese relevante për riintegrimin ekonomik përfshin një rishikim të rregulloreve ekzistuese, dokumenteve strategjike, planeve të veprimit dhe operacionale, raporteve për zbatim, teksteve gazetareske, etj. Gjithashtu u rishikua literatura shkencore nga praktikantët në shtetet e tjera dhe komunitetet lokale që përballen me këtë problem.

Pas shqyrtimit të literaturës ekzistuese, filloi analiza e të dhënave të disponueshme publike, si të dhëna demografike, ekonomike, sociale, të dhëna arsimore, si dhe të dhëna nga tregu i punës. Të dhënat janë përdorur për të perceptuar situatën dhe për të propozuar politika/masa për riintegrimin ekonomik, të bëra në bazë të të dhënave të disponueshme.

Gjatë përgatitjes së Planit ekonomik për riintegrim në nivel lokal, janë marrë njohuritë nga drafti i hulumtimit për nevojat e tregut të punës për të riatdhesuarit dhe familjet e tyre, i cili është realizuar në tranzicionin para përgatitjes së planeve ekonomike.

## Të dhëna themelore për Komunën e Haraçinës

Komuna e Haraçinës është komunë e vendosur në pjesën veriore të Maqedonisë, në pjesën verilindore të Shkupit, me një sipërfaqe prej 24 km<sup>2</sup>. Për nga numri i popullsisë, Komuna e Haraçinës është komunë me popullsi të dendur, me një dendësi mesatare prej 500 banorë për 1 km<sup>2</sup>. Vendbanimet në kuadër të komunës janë Haraçina me 2.250 familje, Orllanca me 140 familje, Grushina me 180 familje, Mojanca me 50 familje.

Komuna konsiderohet si një nga komunat më të varfra në rajonin e Shkupit, por edhe në vend, me një buxhet prej rreth 300 mijë euro.

Sa i përket strukturës etnike, në Komunën e Haraçinës jetojnë 90,72% shqiptarë, 8,23% maqedonas dhe 1% pjesëtarë të bashkësive tjera etnike.

Sipas të dhënave nga regjistrimi i fundit i vitit 2002, për nga struktura e moshës së popullsisë, mund të vërehet se Komuna e Haraçinës është komuna me popullsinë më të re në Republikën e Maqedonisë. Gjegjesisht, në komunë 32.84% e banorëve janë nga mosha 0-14 vjeç, 62.73% nga mosha 15-64 vjeç dhe 4.28% janë mbi 64 vjeç.

Në kuadër të komunës është edhe shkolla fillore “Gjergj Kastrioti Skënderbeu” në f. Haraçinë, me më shumë se 1000 nxënës dhe shkolla fillore “Bajram Shabani” në f. Grushinë.

Komuna është themeluar në vitin 1996 dhe që nga themelimi e deri më sot përballlet me sfida serioze sa i përket infrastrukturës në komunë, pra problemit të menaxhimit të mbeturinave, furnizimit me ujë, ujërave të zeza dhe problemit të kanalit të hapur.

Në komunë nuk ka asnjë çerdhe. Sipas Programit për punë të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut për periudhën 2022-2024, planifikohet të përfundojë ndërtimi i 10 çerdheve në vend që kanë filluar në vitin 2022, duke përfshirë një çerdhe në Komunën e Haraçinës, e cila do të ketë mundësinë të pranojë 102 fëmijë.



## Risocializimi, rehabilitimi dhe riintegrimi i të riatdhesuarve dhe anëtarëve të familjeve të tyre

Procesi i riintegritit të riatdhesuarve dhe anëtarëve të familjeve të tyre kërkon një qasje gjithëpërfshirëse, të integruar dhe të koordinuar, si në planifikim, ashtu edhe në pjesën e zbatimit.

Riintegrimi paraqet një proces kompleks dhe afatgjatë që përfshin masa politike, të sigurisë dhe socio-ekonomike, përmes të cilave të riatdhesuarit dhe familjarët e tyre fitojnë statusin civil, punësohen, pra mundësinë për të realizuar të ardhurat e tyre për veten dhe familjen e tyre.

Sipas hulumtimit të bërë nga Organizata Ndërkombëtare e Punës (ONP), nevojitet një periudhë minimale prej 2 deri në 3 vjet që riintegrimi të zbatohet dhe të jetë i suksesshëm, dhe 3 deri në 5 vjet shtesë për të bërë një vlerësim të plotë se çfarë është bërë<sup>2</sup>. Në përgjithësi, nevojitet një periudhë prej 5 deri në 8 vjet për të qenë në gjendje të konstatohet nëse ish-luftëtarët janë riintegruar me sukses apo pa sukses në shoqëri.

Komuniteti lokal, qeveria dhe sektori joqeveritar duhet të krijojnë me kujdes programe dhe masa, të cilat do të hartohen për të kontribuar në sigurinë dhe stabilitetin e shoqërisë dhe krijimin e zhvillimit të qëndrueshëm. Programet dhe planet për riintegrim do të realizohen duke siguruar burime dhe kapacitete financiare që do të mund të zbatojnë të gjithë procesin, ku qëllimi kryesor i programeve është riintegrimi i qëndrueshëm.

Planifikimi participativ, pra pjesëmarrja e përfaqësuesve të pushtetit kombëtar dhe lokal, liderëve në komunitete, ish-luftëtarëve do të jetë me rëndësi të madhe për zhvillimin dhe zbatimin me sukses të planeve dhe programeve. Përfshirja e të riatdhesuarve dhe anëtarëve të familjeve të tyre në procesin e planifikimit do t'i japë procedurës një ton realist, duke përjashtuar abstrakten e aktiviteteve të planifikuara.

Një ekip multidisiplinar (punëtorë socialë të trajnuar, psikologë, pedagogë dhe ekspertë të tjerë) që ka njohuri eksperte për këtë problem, trajnimi i stafit mësimdhënës që do të përfshihet në procesin arsimor, psikologë dhe mjekë të trajnuar shkollorë janë të një rëndësie thelbësore për riintegrimin e suksesshëm.

Riintegrimi social në thelb përfaqëson pranimin e ish-luftëtarëve nga shoqëria ose rivendosjen e kohezionit social ndërmjet ish-luftëtarëve dhe anëtarëve të tjerë të komunitetit. Për këtë qëllim, informimi i publikut dhe rritja e ndërgjegjësimit publik në shoqëri janë vendimtare për të thithur stigmatizimin dhe për të relaksuar presionin e shoqërisë ndaj grupeve të tilla të qytetarëve. Sepse

---

<sup>2</sup> NiUson.A.(2005), Reintegrating Ex-combatants in Post-Conflict Societies”, Swedish International Development Cooperation Agency, Stockholm, p.88.

stigmatizimi social i këtyre personave, mungesa e punës dhe e mjeteve të jetesës mund të çojë në anëtarësimin e tyre në struktura të caktuara kriminale apo grupe militante.

Në këtë dokument do të bëjmë një pasqyrë të veçantë të masave dhe aktiviteteve për riintegrimin ekonomik, si segment i veçantë i gjithë procesit të riintegrit. Dokumenti do të përfshijë gjithashtu kualifikimet dhe aftësitë arsimore që duhet të fitojnë kategoritë e rrezikuara të qytetarëve, si një parakusht i rëndësishëm për gjetjen e punësimit, por edhe për një integrim të plotë të suksesshëm.

## Riintegrimi ekonomik – Qëllimi strategjik dhe masat

Aktivitetet kryesore për forcimin ekonomik dhe punësimin për kategoritë e cenueshme të qytetarëve, duke përfshirë edhe të riatdhesuarit dhe anëtarët e familjeve të tyre, kërkojnë një qasje holistike në drejtim të krijimit të masave, si dhe shkëmbimit të të dhënave dhe informacioneve.

Fillimisht duhet të fillojmë nga konteksti lokal i komunës, se cilat degë ekonomike janë të zhvilluara, cilat kanë potencial për zhvillim, qofshin fabrika apo objekte të tjera më të vogla prodhuese, të cilat do të ishin vende pune potenciale për të papunët. Sidomos nëse merret parasysh fakti se problemi i transportit për në dhe nga vendi i punës (nëse nuk është në zonën e komunës) është problem i madh për banorët e Haraçinës.

Përshtypja e përgjithshme është se në Komunën e Haraçinës nuk ka një numër të mjaftueshëm të kompanive që mund të ofrojnë punësim. Problemi kryesor është mungesa e infrastrukturës, pra mungesa e ujit, kanalizimit, problemet e shpeshta me furnizimin me energji elektrike etj. E gjithë kjo paraqet një klimë të pafavorshme për zhvillimin e bizneseve. Megjithatë, përkundër këtyre problemeve, ka disa fabrika më të vogla për paketimin e produkteve ushqimore, një fermë shpendësh, punishte artizanale për këpucë, çanta (të cilat u zhvendosën nga Çarshia e Vjetër pas fluksit të produkteve të lira turke dhe kineze). Prodhimi i mobileve dhe drugdhendjes është një degë që po zhvillohet me mjaft sukses në Haraçinë dhe ka potencial të madh për ofrimin e vendeve të reja të punës. Natyrisht, vendndodhja, klima e favorshme, toka e punueshme, si dhe afërsia me aeroportin e Shkupit, ofrojnë bazë të mirë për zhvillimin e bujqësisë, blegtorisë dhe ofrimin të shërbimeve të transportit.

Një nga problemet më të mëdha për punësimin e grave në Komunën e Haraçinës është kujdesi për shtëpinë dhe fëmijët. Kjo, në kushtet kur në komunë nuk ka ende asnjë kopsht fëmijësh, e vështirëson edhe më shumë punësimin. Për shkak të kësaj, gratë mund të përfshiheshin në punë të caktuara që do t'i kryenin nga shtëpia, si: thurje, qëndisje, qepje, përgatitje të pjekjeve të ndryshme dhe ëmbëlsirave.

Një nga mekanizmat ekzistues që mund të përdoret në integrimin ekonomik është Plani operativ për programet dhe masat aktive për punësim dhe shërbime në tregun e punës për vitin 2022.<sup>3</sup> Me Planin operativ për programet dhe masat aktive për punësim dhe shërbime në tregun e punës për vitin 2022 përcaktohen programet, masat dhe shërbimet për punësim që do të sigurojnë hapjen e vendeve të reja të punës, rritjen e punësueshmërisë së të papunëve, veçanërisht të rinjve, personave të papunë afatgjatë dhe përfituesit e së drejtës për ndihmë financiare nga mbrojtja sociale, si dhe mbështetje për personat e papunë të cilëve u është regjistruar ndërprerja

---

<sup>3</sup> <https://www.mtsp.gov.mk/dokumenti.nsp>

e marrëdhënies së punës gjatë periudhës së krizës së shkaktuar nga virusi corona COVID 19 (nga 11.03.2020).

Plani ekonomik për integrim parashikon masa në 4 grupe dhe konkretisht: identifikimi i barrierave, orientimi në karrierë, fuqizimi i kualifikimeve dhe shkathtësive, punësimi i subvencionuar dhe vetëpunësimi.

### Identifikimi i barrierave me të cilat përballen të riatdhesuarit dhe anëtarët e familjeve të tyre në tregun e punës

Identifikimi i barrierave në tregun e punës duhet të bëhet nga këshilltarët e karrierës të cilët mund të përfaqësojnë një hallkë vendimtare në procesin e zhvillimit profesional. Në drejtim të punësimit të tyre të denjë, ka disa pengesa të mundshme me të cilat mund të përballen si: mungesa e arsimit adekuat, mungesa e përvojës së punës, kujdesi për anëtarët e familjes, gjendja e keqe financiare, puna joformale, qasja e kufizuar në arsim, shëndeti i kufizuar dhe mbështetja sociale, mungesë informacioni për mundësitë, stigmatizimi, mungesa e mundësive për jetesë, dekurajimi dhe të tjera.

Qendra për punësim në Shkup përmes zyrës në Komunën e Haraçinës ka qasje në kategoritë e cenueshme të qytetarëve dhe duhet të animojë komunitetin lokal nga Komuna e Haraçinës, organizatat e shoqërisë civile dhe sektorin privat lokal që mund të jetë me përfitim të madh gjatë gjithë procesit të integritit ekonomik.

### Orientimi në karrierë

Orientimi profesional dhe këshillimi për karrierë u mundëson të papunëve të zhvillojnë aftësitë e kërkimit të punës, planifikimin dhe menaxhimin e zhvillimit të karrierës së tyre, ndihmë në zgjedhjen e një profesioni, trajnimi ose punësimi, si dhe mbështetje shtesë në vlerësimin e potencialit të tyre për punësim dhe përshtatjen e tyre me nevojat reale në tregun e punës.

Orientimi në karrierë<sup>4</sup> është një shërbim që lidhet ngushtë me planet individuale të zhvillimit. Këshilltarët e karrierës në bashkëpunim me zyrën e punësimit në Haraçinë dhe Qendrën për punë sociale duhet t'i ndihmojë kategoritë e cenueshme në tregun e punës duke përfshirë të riatdhesuarit dhe anëtarët e familjeve të tyre që të menaxhojnë me karrierën e tyre, të bëjnë zgjedhjen e duhur në arsim, trajnim dhe mbi të gjitha në zgjedhjen e profesionin e duhur. Orientimi në karrierë përfshin disa aktivitete të ndërlidhura: orientimi në edukim dhe informacion për karrierë, këshillim individual dhe grupor, vlerësim të shkathtësive dhe vlerësim psikometrik, ndihmë për kërkimin e punës, ndërmjetësim për rekrutim me punëdhënësit dhe orientim për zhvillimin e shkathtësive të nevojshme për kërkimin e punës dhe vetëpunësimin.

---

<sup>4</sup> Në disa shtet termat si “këshillim në karrierë”, “zhvillim i karrierës”, “informacion për karrierën, këshilla dhe udhëzime”, “këshillim profesional” ose “udhëzim profesional” i referohen gamës së aktiviteteve të përfshira këtu brenda nocionit të orientimit në karrierë.

Këshilltarët e karrierës në nivel lokal mund të jenë profesionistë në profesionin e tyre nga komuna, por mbi të gjitha duhet të jenë njerëz nga komuniteti lokal që mund të fitojnë besimin e të riatdhesuarve dhe anëtarëve të familjeve të tyre.

### Forcimi i kualifikimeve dhe shkathtësive lidhur me punësimin

Trajnimet profesionale ofrojnë zhvillim të shkathtësive në një gamë të gjerë fushash profesionale, përmes mësimin në klasë dhe në vendin e punës. Ato duhet të dizajnohen për të ndërtuar aftësitë dhe njohuritë e këtyre individëve, të cilat janë në përputhje me nevojat e punëdhënësve. Këto trajnime luajnë një rol kyç në sigurimin e punësimit më të mirë afatgjatë<sup>5</sup>.

Trajnimet për plotësimin e profesioneve të kërkuara në tregun e punës nga zbatues të verifikuar të trajnimit (trajnime profesionale)<sup>6</sup>, u referohen profesioneve që do të jenë të kërkuara nga punëdhënësit. Ato kryhen nga ofruesit e verifikuar të trajnimeve (shkollat e mesme profesionale, ndërmarrjet private, odat ekonomike, dhomat odat e artizanatit, etj.). Trajnimet realizohen në një periudhë prej 2 deri në 6 muaj, në varësi të profesionit që studiohet.

Në vitin 2021, personat që e kanë ndjekur trajnimin përmes masës kanë marrë kompensim mujor në shumë prej 9.000 denarë, përfshirë sigurimin në rast aksidenti në vendin e punës dhe tatimin mbi të ardhurat personale për kohëzgjatjen e trajnimit nga 2 deri në 4 muaj. Punëdhënësi, nëpërmjet bashkëfinancimit, mund të rrisë shumën e kompensimit mujor për kohëzgjatjen e trajnimit, që do të pasqyrohet në kontratë në përputhje me rrethanat. Ofruesit e trajnimeve marrin kompensim deri në 30.000 denarë për person në trajnim.

Pas përfundimit të trajnimit dhe dhënies së provimit, personi i papunë pajiset me certifikatë kualifikimi për profesionin/aftësinë. Në rajonin e Komunës së Haraçinës nuk ka ofrues të verifikuar të trajnimeve, të cilët ofrojnë kualifikime nga fusha të ndryshme, por në rajonin e Qytetit të Shkupit janë rreth 80 trajnime të verifikuara nga fusha të ndryshme. Mundësitë për trajnim në nivel të Qytetit të Shkupit, në të cilat këta persona mund të marrin pjesë dhe të fitojnë kualifikimet e nevojshme, mund t'i shihni në ueb faqen e Qendrës për arsim të të rriturve në linkun e mëposhtëm [Lista e programeve – TIS \(cov.gov.mk\)](#).

Trajnimet e financuara nga Agjencia për punësim përmes Qendrës për punësim - Shkup janë shumë të kufizuara, sepse varen nga interesimi i të papunëve për të formuar grupe të interesuara për të njëjtin lloj trajnimi në të njëjtin vend, dhe nga disponueshmëria e ofruesve të verifikuar të trajnimit. Në vitin 2022, me trajnime të ndryshme në përputhje me Planin operativ për programet dhe masat aktive për punësim dhe shërbime në tregun e punës, është planifikuar të përfshihen rreth 800 persona me trajnime profesionale.

---

<sup>5</sup> Vocational Education and Training (VET) and Adult Learning, OECD 2022.

<sup>6</sup> Të njëjtat janë pjesë e Planit operativ për programe dhe masa aktive për punësim dhe shërbime në tregun e punës.

Komuna e Haraçinës mund t'i realizojë trajnimet në bashkëpunim me zbatuesit tashmë të verifikuar të trajnimeve. Gjithashtu, në bashkëpunim me punëdhënësit me përgjegjësi shoqërore, organizatat civile me mision social dhe odat mund të iniciojnë dhe krijojnë në mënyrë të pavarur ofrues të cilët do të zbatojnë trajnime të verifikuara.

Krahas trajnimeve për plotësimin e profesioneve të kërkuara në tregun e punës nga zbatues të verifikuar të trajnimeve, në përputhje me Planin operativ për programet dhe masat aktive për punësim dhe shërbime në tregun e punës, ekzistojnë edhe lloje të tjera trajnimesh, si p.sh. Trajnim në vendim e punës për punëdhënësit të njohur, Trajnim on-line, Trajnim për zhvillimin e shkathtësive digjitale, Praktikë, Trajnim për gjuhë të huaja, etj. Ato përfaqësojnë një mundësi të mirë punësimi, veçanërisht për njerëzit që tashmë kanë aftësi që kërkohen nga punëdhënësit. Këto trajnime realizohen nga Agjencia për punësim, përmes Qendrës për punësim - Shkup. Në territorin e Komunës së Haraçinës nuk ka trajnime të verifikuara të shkathtësive, por në territorin e Qytetit të Shkupit ka 12 trajnime të verifikuara të shkathtësive, të cilat mund të shihen në ueb faqen e Qendrës për arsim të të rriturve ose në linkun e mëposhtëm [Lista e programeve – TIS \(cov.gov.mk\)](http://Lista_e_programeve_-_TIS(cov.gov.mk)).

Duke pasur parasysh se nuk ka infrastrukturë të zhvilluar për arsimin formal profesional në Haraçinë, trajnimi në vendin e punës për punëdhënësit e interesuar nga ndërtimtaria, bujqësia, prodhimi dhe tregtia duhet të përfaqësojë një mundësi adekuate për avancim në karrierë.

### **Punësimi i subvencionuar në organizatat qytetare me mision social (ndërmarrje sociale) ose ndërmarrje me përgjegjësi shoqërore**

Punësimi me pagë të subvencionuar është një masë aktive që zbatohet nga Agjencia e punësimit përmes qendrave të punësimit në nivel lokal prej më shumë se 10 vitesh. E njëjta gjë është një mundësi e mirë për njerëzit më të cenuar në tregun e punës. Punësimi i subvencionuar mund të realizohet përmes punësimit të këtyre personave në organizata qytetare me mision social ose/dhe ndërmarrje sociale. Punësimi i subvencionuar duhet të kombinohet me trajnimin dhe mentorimin, me synimin e integritetit afatgjatë në tregun primar të punës.

Me masën në vitin 2021 subvencionohen pagat në shumë prej 19.000 denarë në muaj si subvencion për pagën e të punësuarit për periudhën 3, 6 ose 12 muaj. Punëdhënësi mund t'i paguajë të punësuarit një pagë më të lartë. Mbështetja e përgjithshme financiare për një person për një periudhë 3 mujore është 57.000 denarë; për 6 muaj është 114.000 denarë dhe për 12 muaj është 228.000 denarë. Mjetet paguhen një herë për të gjithë periudhën e subvencionimit, pas punësimit me kohë të plotë, në përputhje me dispozitat dhe kushtet e përcaktuara në Marrëveshjen e subvencionit. Në vitin 2022, kjo masë është planifikuar të mbulojë rreth 1500 persona nga kategoritë e cënueshme.

Grupet e cënueshme mund të ndahen në nëngrupe sipas distancës së tyre nga tregu i punës. (p.sh. vlerësimi i kohës dhe përpjekjes së nevojshme për t'i punësuar ato). Personave që janë më

larg nga tregu i punës duhet t'u ofrohet punësim i subvencionuar në organizatat qytetare me mision social, të cilat janë të specializuara për aktivizim dhe punësim në tregun e punës.

Personat që janë më të përgatitur për punësim mund të mbështeten me subvencione punësimi për të hyrë në tregun primar të punës, pa përfshirë ndërmarrjet sociale. Gjithashtu, personat që janë më të gatshëm për punësim mund të punësohen në ndërmarrje me përgjegjësi shoqërore. Të gjithë këta persona duhet të mbështeten më tej me këshillim, mentorim dhe trajnim.

Bashkëpunimi me sektorin e shoqërisë civile dhe hartëzimi i organizatave të shoqërisë civile mund të jetë hapi i parë në krijimin e një infrastrukture për aktivizim dhe punësim. Lista e organizatave qytetare në nivel të Komunës së Haraçinës (si dhe Qytetit të Shkupit) mund të gjendet në ueb faqen e Regjistrimit Qendror në linkun e mëposhtëm [Sistemi për regjistrim të centralizuar të përdoruesve – Regjistrimi Qendror o Republikës së Maqedonisë së Veriut \(crm.com.mk\)](http://crm.com.mk).

### Vetëpunësimi

Vetëpunësimi është një masë adekuate për njerëzit që duan të hapin biznesin e tyre dhe të kenë njohuri dhe aftësi. Me këtë masë, të papunët mbështeten në themelimin e kompanisë së tyre, duke formalizuar një veprimtari tashmë ekzistuese (joformale), përmes granteve për pajisje dhe materiale.

Pjesëmarrësit në masë i nënshtrohen trajnimit prej 30 orësh për ndërmarrësinë dhe përgatimin ide biznesi. Kandidatët më të mirë marrin ndihmë shtesë këshilluese për zhvillimin e një plani biznesi. Gjatë përgatitjes së planit të biznesit, pjesëmarrësit kanë mbështetjen e një këshilltari që i udhëzon në procesin e përgatitjes. Pas përfundimit të planit të biznesit, bëhet një renditje nga një komision ekspertësh dhe kandidatët më të mirë marrin fonde të pakthyeshme për blerjen e pajisjeve dhe/ose materialeve për fillimin e biznesit.

Masa e vetëpunësimit mund të përfaqësojë një mundësi të mirë për qasje në kapital, në rast se personi ka aftësi mikro-biznesi. Mbështetja financiare në materiale dhe pajisje arrin në rreth 5.000 euro. Trajnimet dhe këshillimet për ndërmarrësinë që ndihmojnë në krijimin e një plani biznesi janë të një rëndësie të madhe për suksesin dhe qëndrueshmërinë e bizneseve.

## Rekomandime

1. Të riadhesuarit dhe anëtarët e familjeve të tyre duhet t'i marrin ato shërbime dhe masa të disponueshme që i përshtaten më mirë nevojave të tyre individuale. Masat dhe shërbimet e ofruara nga Agjencia e punësimit nuk janë mjaft të përshtatura për nevojat e këtyre personave dhe për këtë arsye nevojiten masa si orientimi në karrierë nga persona të komunitetit lokal që do t'i ndihmojnë ata në integrimin ekonomik. Këshilltarët e karrierës duhet të ndërtojnë besim me të riadhesuarit dhe anëtarët e familjeve të tyre. Këshilltarët e karrierës duhet të jenë njerëz që mund të fitojnë besimin e të riadhesuarve dhe anëtarëve të familjes së tyre. Udhëzimet në karrierë nuk duhet të ndalen me punësimin e personave, duke pasur parasysh se ata mund të jenë sërish të papunë. Në Komunën e Haraçinës mund të vihen në hartë njerëzit që kanë reputacion dhe besim nga komuniteti lokal. Ata duhet t'i ndihmojnë të riadhesuarit dhe anëtarët e familjeve të tyre në punësim.
2. Aktivitetet kryesore që do të ndërmerren janë identifikimi i barrierave në tregun e punës, këshillimi dhe dhënia e informacionit për karrierën, orientimi drejt arsimit formal dhe joformal, trajnimi në klasë dhe/ose në vendin e punës, zhvillimi i shkathtësive të nevojshme për kërkimin e punës, asistencë gjatë kërkimit të punës, punësim me pagë të subvencionuar dhe vetëpunësim.
3. Trajnimet luajnë një rol kyç në sigurimin e punësimit më të mirë afatgjatë në mesin e personave që nuk kanë aftësi adekuate në tregun e punës. Trajnimet në vendin e punës që mund të zbatohen janë kryesisht në bujqësi, ndërtimtari, prodhim dhe tregti. Një kombinim i trajnimit me punësim të subvencionuar ose vetëpunësim mund të çojë në punësim të denjë për të riadhesuarit dhe anëtarët e familjeve të tyre.
4. Qendra për punësim - Shkup përmes zyrës së disperzuar në Komunën e Haraçinës mund të përfaqësojë një mundësi të mirë për informim më të mirë, aktivizim të tregut të punës dhe punësim. Ka një numër të madh masash dhe programesh në të cilat mund të marrësh pjesë dhe të sigurohet punësim.